

L I G J
Nr.8095, datë 21.3.1996

PËR SHËRBIMIN CIVIL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ligji për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë rregullon marrëdhëniet juridike të punës të punonjësve të administratës publike, qendrore dhe lokale dhe të institucioneve buxhetore, të cilat nuk rregullohen me ligje të veçanta ose me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Shërbimi civil

Në shërbimin civil të Republikës së Shqipërisë bëjnë pjesë:

1. Funksionarët politikë, pozita juridike e të cilëve përcaktohet me ligje të veçanta dhe me dispozitat e kreut të dytë të këtij ligji.

2. Nëpunësit civilë, të cilët ushtrojnë në administratën publike detyra me karakter drejtues, organizativ, kontrolli dhe ekzekutiv. Në varësi nga rrethi i kompetencave dhe i detyrave të përcaktuara në strukturën organizative të administratës publike, të cilave u përgjigjet një nivel i caktuar i pagave e pensione, nëpunësit civilë ndahen në nëpunës të nivelit të lartë drejtues, nëpunës të nivelit të mesëm drejtues, nëpunës të nivelit të ulët drejtues dhe në specialistë. Pozita juridike e nëpunësve për të gjitha këto nivele përcaktohet në bazë të dispozitave të kreut të tretë të këtij ligji.

3. Nëpunësit e thjeshtë, të cilët brenda administratës publike kryejnë detyra shërbimi. Marrëdhëniet juridike të këtyre nëpunësve rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës.

Marrëdhëniet juridike të punonjësve të organeve të drejtësisë dhe pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë rregullohen me dispozita juridike të veçanta.

Marrëdhëniet juridike të punonjësve të sistemit arsimor dhe të shërbimit shëndetësor rregullohen nga Kodi i Punës.

Neni 3
Baza juridike

Marrëdhëniet juridike në shërbimin civil rregullohen në bazë të dispozitave kryesore kushtetuese nga ky ligj dhe në përputhje me dispozitat e veçanta për organizimin e funksionimin e organeve dhe të degëve të caktuara të administratës publike, me rregulloret e tyre, si dhe me aktet nënligjore të dala në bazë e për zbatimin të tyre.

Neni 4
Qëllimi i ligjit

Rregullimi ligjor i marrëdhënieve juridike në shërbimin civil synon garantimin e të drejtave e të kushteve të përshtatshme për punonjësit e administratës publike për plotësimin sa më mirë, në

përputhje me legjislacionin në fuqi, të detyrave të administratës publike, harmonizimin e elementit politik të veprimtarisë së organeve administrative me elementet tekniko-administrative të saj, për të siguruar vijimësinë në veprimtarinë e administratës publike, sanksionimin e të drejtave e të detyrimeve të nëpunësve, si dhe në vendosjen e rregullave unike për fillimin dhe marrjen fund të marrëdhënies së tyre juridike, zhvillimin e karrierës, kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së nëpunësve.

Neni 5

Marrëdhënia juridike e shërbimit civil

Marrëdhënia juridike e shërbimit civil është marrëdhënie juridike që krijohet ndërmjet personit të zgjedhur a të emëruar dhe shtetit.

Në këtë marrëdhënie juridike shteti përfaqësohet nga organi ose institucioni që në bazë të ligjit bën zgjedhjen a emërimin e tyre.

Neni 6

Futja në shërbimin civil

Futja në shërbimin civil bëhet me përzgjedhje dhe me emërim, sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara me ligje të veçanta, sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në këtë ligj dhe në akte nënligjore.

Personat që futen në shërbimin civil të Republikës së Shqipërisë duhet të kenë shtetësinë shqiptare, të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale të domosdoshme për vendin përkatës të punës dhe të japin garanci të plota për angazhimin e tyre në mbrojtje të kushtetutës e të rendit juridik demokratik.

Në raste të veçanta, në shërbimin civil të Republikës së Shqipërisë, mund të futen edhe shtetas të huaj me cilësinë e nëpunësit civil, kur një gjë e tillë i përgjigjet interesave të shtetit shqiptar dhe është e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga marrëveshje ndërkombëtare.

Neni 7

Kohëzgjatja e marrëdhënies juridike

Marrëdhënia juridike e shërbimit civil zgjat:

1. Pa afat, për nëpunësit civilë të të gjitha niveleve drejtuese dhe për specialistët.
2. Me afat, që përcaktohet nga mandati politik, për funksionarët politikë.
3. Me afat të caktuar, kur kjo gjë është përcaktuar me dispozita të veçanta juridike.
4. Me afat prove për nëpunësit në provë.

Neni 8

Emërimi dhe lirimi nga detyra

Emërimi dhe lirimi nga detyra në shërbimin civil bëhet nga organi ose institucioni që në bazë të ligjit e gëzon këtë të drejtë.

Emërimi i bërë nga një organ a institucion, i cili nuk e gëzon këtë të drejtë, është i pavlefshëm. Emërimi është i pavlefshëm edhe kur:

1. Personi i emëruar nuk plotëson kushtin për shtetësinë, në bazë të paragrafit 2 të nenit 6, dhe nuk është bërë përjashtim në bazë të paragrafit 3 të nenit 6.
2. Personi i emëruar nuk ka zotësi për të vepruar.
3. Në bazë të ligjit, personi i emëruar nuk gëzon të drejtën për të punuar në administratën publike.

Marrëdhënia juridike e shërbimit civil fillon në momentin e emërimit dhe zgjat deri në lirimin nga detyra ose derisa të zgjasë afati ligjor i ushtrimit të veprimtarisë. Marrëdhënia juridike e shërbimit civil merr fund gjithashtu:

- a) Kur personi vdes.
- b) Kur personi del në pension.
- c) Kur personi është dënuar me vendim të gjykatës të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

- d) Kur personi jep dorëheqjen.
- dh) Për një nga arsyet e përmendura në pikat 1, 2 dhe 3 të paragrafit të mësipërm.
- e) Kur personi është i paaftë për të kryer detyrat në shërbimin civil.

Neni 9

Akti i emërimit

Organi ose institucioni që bën emërimin, në vendimin ose urdhrin e emërimit, përveç detyrës që do të ushtrojë personi i emëruar, duhet të përmendë edhe nivelin e kësaj detyre në shërbimin civil.

Këshilli i Ministrave në rregullat bazë për strukturën organizative të organeve të administratës publike përcakton edhe nivelin përkatës të shërbimit civil për çdo kategori detyrash. Ai nxjerr dhe aktet nënligjore që përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e aktit të emërimit.

Neni 10

Detyrat e funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë

Në ushtrimin e funksioneve të tyre funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë kanë për detyrë:

1. Të respektojnë dhe të mbrojnë kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë, si dhe rendin juridik demokratik.

2. Të ushtrojnë me përkushtim detyrën, të jenë aktivë, të veprojnë me profesionalizëm, me përgjegjësi dhe me zotësi.

3. Të jenë të paanshëm, objektivë dhe të drejtë, të mos nisen nga interesi i përfitimit personal e të mos krijojnë favore për individë të caktuar, duke u nisur nga motive që nuk përputhen me realizimin me ndërgjegje të detyrës.

4. Të respektojnë parimin e plotësimit me besnikëri të detyrave dhe të funksioneve zyrtare, pavarësisht nga pikëpamja e tyre personale, dhe të zbatojnë me përpikëri urdhrat a vendimet e organeve e të institucioneve eprore.

5. Të mos kërkojnë e të mos pranojnë asnjë përfitim moral e material si rezultat i kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare, me përjashtim të pagës e të shpërblimeve të tjera që u takojnë në bazë të dispozitave përkatëse.

6. Të mbajnë përgjegjësi të plotë për ligjshmërinë e veprimeve të tyre gjatë ushtrimit të detyrës. Kur nuk janë të bindur për ligjshmërinë e urdhrave a të vendimeve që zbatojnë, të informojnë menjëherë organin urdhërues.

7. Të respektojnë parimin e informimit të publikut për veprimtarinë e tyre, me përjashtim të rasteve kur informacionet, në bazë të dispozitave përkatëse, konsiderohen sekret ose për përdorim të brendshëm.

8. Të mos ushtrojnë asnjë punë a veprimtari jashtë detyrës së tyre zyrtare, në qoftë se një gjë e tillë vjen në kundërshtim me detyrat e tyre ose i pengon ata në ushtrimin e këtyre detyrave, si dhe të njoftojnë organin ose institucionin ku punojnë për çdo punë ose veprimtari me pagesë që ushtrojnë jashtë kohës së punës.

Neni 11

Etika e shërbimit civil

Në mbështetje të nenit 10, ngarkohet Këshilli i Ministrave të hartojë rregullat e etikës së shërbimit civil në lidhje me konfliktin e interesave dhe rregullat e sjelljes si dhe dispozita të tjera me karakter etik, së bashku me masat detyruese për zbatimin e tyre nga funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë.

Neni 12

Të drejtat e funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë

Funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë gëzojnë këto të drejta:

1. Të drejtën për të marrë pagë, pension dhe shpërblime të tjera, në përputhje me detyrën që ushtrojnë, sipas dispozitave përkatëse.

2. Të drejtën për të marrë lejen e pushimit të paguar vjetor në masën e përcaktuar me dispozitat përkatëse, si dhe leje pa të drejtë page.

3. Të drejtën për të bërë punë dhe për të ushtruar veprimtari të tjera jashtë detyrës dhe jashtë kohës së punës, në qoftë se një gjë e tillë nuk është në kundërshtim me detyrën e tyre ose nuk i pengon ata në ushtrimin e detyrës.

4. Të drejtën për të marrë trajtim të posaçëm për periudhën e lejes së paguar të pushimit vjetor, në kushtet dhe në masën që përcaktohet me dispozita juridike të veçanta.

5. Të drejtën për të përfituar trajtim shëndetësor, për vete dhe për pjesëtarët e familjes që kanë në ngarkim, në kushtet dhe në masën që përcaktohet nga dispozitat përkatëse.

6. Të drejtën për nënat për të marrë leje lindjeje dhe për baballarët për të marrë leje për t'u kujdesur për fëmijën e porsalindur a për bashkëshorten, sipas kushteve të përcaktuara nga dispozitat përkatëse.

7. Të drejtën për t'u strehuar në kushte të përshtatshme pranë vendit të punës, sipas kritereve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Të drejtën për t'u informuar për çdo akuzë disiplinore që bëhet kundër tyre, për faktet dhe dokumentacionin në të cilat ajo mbështetet, si dhe të drejtën për t'u mbrojtur nga akuza sipas procedurave të rregullta e të paanshme. Këto të drejta dhe normat përkatëse procedurale rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Të drejtën për të përfituar lehtësira udhëtimi dhe trajtim special me veshje, në rastet dhe sipas kushteve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

KREU II POZITA JURIDIKE E FUNKSIONARËVE POLITIKË

Neni 13 Funksionarët politikë

Funksionarët politikë, për të cilët zbatohen dispozitat e këtij ligji, janë të gjithë personat që ushtrojnë funksione drejtuese politike në organet qendrore dhe lokale të administratës publike, titullarë dhe zëvendës të tyre në institucionet publike të specializuara, si dhe personat që ushtrojnë veprimtari të drejtpërdrejtë ndihmëse për realizimin e funksioneve politike të personave të lartpërmendur.

Marrëdhëniet juridike të deputetëve të Kuvendit Popullor, Presidentit të Republikës, e të personave të zgjedhur në organet e pushtetit lokal rregullohen me dispozita juridike të veçanta.

Neni 14 Marrëdhënia juridike e funksionarëve politikë

Marrëdhënia juridike e funksionarëve politikë fillon me zgjedhjen ose emërimin e tyre, sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në dispozitat juridike përkatëse.

Në rast se në ligjet përkatëse nuk përcaktohet ndryshe, marrëdhënia juridike e funksionarëve politikë merr fund për një nga shkaqet e përmendura në paragrafin 3 të nenit 8, si dhe për motive politike.

Neni 15 Postet e funksionarëve politikë

Këshilli i Ministrave, në bazë të legjislacionit përkatës e të kritereve të vendosura nga ky ligj, përcakton të gjitha postet e strukturës organizative të shërbimit civil që do të zihen nga funksionarë politikë.

Neni 16 Të drejta e detyra të veçanta

Funksionarët politikë, në ushtrimin e detyrës së tyre, gëzojnë çdo të drejtë dhe përmbushin çdo detyrim tjetër që buron nga norma të tjera që kanë lidhje me veprimtarinë e tyre.

KREU III
POZITA JURIDIKE E NËPUNËSVE CIVILË

Neni 17
Nëpunësit civilë

Nëpunësit civilë, për të cilët zbatohen dispozitat e këtij ligji, janë të gjithë personat që përmenden në paragrafin 2 të nenit 2, që punojnë në administratën e Kuvendit Popullor, të Presidencës, të organeve qendrore të administratës publike, të institucioneve të specializuara, organeve të pushtetit lokal, me përjashtim të nëpunësve të thjeshtë.

Neni 18
Marrëdhëniet juridike të nëpunësve civilë

Marrëdhëniet juridike të nëpunësve civilë fillojnë me emërimin e tyre dhe janë pa afat.

Marrëdhëniet juridike të nëpunësve civilë marrin fund për një nga shkaqet e përmendura në paragrafin e tretë të nenit 8, ose kur ndaj nëpunësit merret masa disiplinore e largimit nga puna, në bazë të kriterëve të dhëna nga ky ligj dhe rregullave të hartuara nga Këshilli i Ministrave për disiplinën në shërbimin civil, apo kur me mbarimin e periudhës së provës nuk miratohet emërimi.

Neni 19
Emërimi i nëpunësve në shërbimin civil

Emërimi në shërbimin civil për nëpunësit civilë bëhet nëpërmjet përzgjedhjes në konkurse dhe me emërimin pa konkurs.

Emërimi në shërbim civil për nëpunësit civilë bëhet, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj, nga komisioni i shërbimit civil në bashkëveprim me këshillat emërues.

Neni 20
Komisioni i shërbimit civil

Përzgjedhja, sipas kriterëve të vendosura në këtë ligj dhe sipas kërkesave të detyrave përkatëse, e kandidatëve që do të emërohen në shërbimin civil si nëpunës civilë dhe garantimi i mbrojtjes së të drejtave të nëpunësve civilë bëhet nga Komisioni i Shërbimit Civil.

Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë të emëruar nga Këshilli i Ministrave dhe zgjidhet nga radhët e punonjësve të ngarkuar me kontrollin dhe organizimin e shërbimit civil, si dhe nga radhët e personaliteteve të fushave dhe profesioneve të ndryshme. Kryetari i Këshillit të Ministrave emëron kryetarin e komisionit i cili qëndron në këtë detyrë për jo më pak se dy vjet. Përbërja e komisionit dhe ndryshimet në përbërjen e tij shpallen në Fletoren Zyrtare.

Detyra e anëtarit të komisionit është e papajtuashme me detyrën e deputetit të Kuvendit Popullor, të personit të zgjedhur në organet lokale të pushtetit dhe të anëtarit të Këshillit të Ministrave.

Anëtari i komisionit duhet të ketë mbushur moshën 30 vjeç dhe lirohet nga detyra pasi të ketë mbushur moshën 60 vjeç.

Anëtarët e komisionit lirohen nga detyra kur japin dorëheqjen, kur vërtetohet se nuk janë të aftë për të ushtruar detyrën ose kur kryejnë një vepër, që për nëpunësin civil do të sillte largimin nga puna. Zëvendësimi i anëtarëve të komisionit bëhet nga Këshilli i Ministrave sipas rregullave dhe kriterëve të përmendura më sipër.

Shpërblimi i anëtarëve të komisionit caktohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 21
Delegimi i kompetencave

Komisioni i shërbimit civil punëson pranë tij nëpunës civilë, sipas rregullave të vendosura nga Këshilli i Ministrave, të cilët, me autorizim të komisionit, mund të ushtrojnë kompetenca të caktuara të

tij. Autorizimi jepet me shkrim dhe në të duhet të gjejnë pasqyrim emri i nëpunësit që do të ushtrojë kompetencën e deleguar, detyra që do të ushtrojë në emër të komisionit, kushtet përkatëse për realizimin e saj dhe koha e ushtrimit të detyrës.

Nëpunësit civilë të Komisionit nuk mund të kenë kompetencë për përzgjedhjen e personave për postet nga drejtor drejtorie në ministri e lart, si dhe në postet e barazuara me to.

Komisioni mund të krijojë nënkomisione në ministri, prefektura dhe organet e pushtetit lokal. Këto nënkomisione ushtrojnë detyra që janë në kompetencë të komisionit dhe që janë deleguar prej tij. Anëtarët e nënkomisioneve emërohen nga Komisioni, me propozimin e organeve pranë të cilëve ato krijohen dhe duhet të jenë nëpunës civilë me nivel detyre jo më të ulët se ajo e drejtorit të drejtorisë së institucionit përkatës e lart. Përzgjedhja e personave për këto poste bëhet nga komisioni.

Nënkomisionet nuk janë organe të përhershme. Ato shkrihen menjëherë pasi kryejnë kompetencat që u janë deleguar dhe anëtarët e tyre, për periudhën e anëtarësisë në nënkomision, marrin shpërblim në masën e caktuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 22

Këshilli emërues

Në çdo organ a institucion të shërbimit civil funksionon këshilli emërues i përbërë nga tre anëtarë, nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues. Anëtarët e këshillit emërues caktohen nga titullari i organit a institucionit dhe miratohen nga Kryetari i Këshillit të Ministrave. Njëri nga anëtarët është i përhershëm, kurse dy anëtarët e tjerë caktohen sipas fushës konkrete për të cilën do të veprojnë këshilli në rastin konkret.

Këshilli emërues ka për detyrë të bashkërendojë veprimtarinë për emërtimet në organin a institucionin përkatës, të shqyrtojë kandidaturat e paraqitura nga komisioni i shërbimit civil, të mbikëqyrë vlerësimet e punës për nëpunësit civilë dhe të kontrollojë masat disiplinore që merren ndaj tyre.

Këshilli emërues mund të bëjë përzgjedhje të kandidaturave për nëpunës civilë vetëm në rastet kur ushtron detyrat e nënkomisionit të shërbimit civil.

Emërimi i nëpunësve civilë bëhet nga titullari i organit a institucionit, sipas propozimit të këshillit emërues. Këshilli emërues mund të bëjë emërimin e nëpunësve civilë në rast se autorizohet për këtë gjë nga titullari i organit a institucionit.

Me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht në këtë ligj për integrimin e nëpunësve ekzistues dhe për emërimet pa konkurs, emërimi i nëpunësve civilë mund të bëhet vetëm nga radhët e kandidatëve të përzgjedhur nga komisioni i shërbimit civil ose nga nënkomisionet, të cilëve u është deleguar kjo përgjegjësi.

Neni 23

Zgjedhja me anë të konkurseve

Konkurset për zgjedhjen e kandidatëve për nëpunës civilë organizohen nga komisioni i shërbimit civil. Konkursët organizohen për përzgjedhjen e kandidatëve për kategori postesh që herë pas here mbeten bosh, si dhe për plotësimin e vendeve të veçanta të punës në shërbimin civil.

Konkurset për kategori të caktuara postesh organizohen me kërkesën e Këshillit të Ministrave ose të organeve të caktuara prej tij. Konkursët për poste të caktuara organizohen me kërkesën e këshillave emërues përkatës. Nuk organizohen konkurse për poste të caktuara kur komisioni ka bërë përzgjedhje kandidatësh me anë të konkurseve për kategori postesh ose është duke e bërë këtë përzgjedhje dhe kandidatët e përzgjedhur plotësojnë kushtet për postin në fjalë.

Komisioni i shërbimit civil, pas çdo konkursi, harton një listë që përmban emrat e kandidatëve më të mirë të vlerësuar në konkurs, të renditur sipas rezultateve të tyre.

Për çdo emërim që do të bëhet pas organizimit të konkursit për një a disa poste të caktuara, komisioni i paraqet këshillit emërues emrat e deri tre kandidatëve të parë, të cilët nuk janë emëruar ende në poste që kanë lidhje me konkursin. Kandidati që do të emërohet zgjidhet nga këshilli emërues dhe i propozohet titullarit të organit a institucionit për t'u emëruar.

Për çdo emërim që do të bëhet pas organizimit të konkursit për një kategori postesh, komisioni i paraqet këshillit emërues emrat e tre deri pesë kandidatëve të parë që nuk janë emëruar ende në

kategorinë përkatëse për të cilën është organizuar konkursi. Kandidati që do të emërohet zgjidhet nga këshilli emërues dhe i propozohet titullarit të organit a institucionit për t'u emëruar.

Procedurat për zgjedhjen e kandidatëve, organizimin dhe përmbajtjen e konkurseve, si dhe rregullat për formën dhe përmbajtjen e njoftimit publik me anë të medias përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Emërimet pa konkurs

Emërimet e nëpunësve civilë mund të bëhen edhe pa konkurs kur:

1. Komisioni i shërbimit civil vendos që një kategori postesh në shërbimin civil të plotësohet me anë të ngritjes në detyrë ose të qarkullimit të nëpunësve civilë. Ky emërim bëhet kur nëpunësi plotëson kushtet e vendosura nga komisioni për kualifikimin, kohëzgjatjen e shërbimit, periudhën e provës etj. Komisioni mund të intervistojë kandidatin për postin e ri.

2. Këshilli emërues vërteton se një nëpunës civil gëzon kualifikimin e nevojshëm për një post të caktuar dhe ky post mund të zihet me anë të ngritjes në detyrë a të qarkullimit, duke plotësuar kushtet e vendosura nga komisioni për kualifikimin, kohëzgjatjen e shërbimit, periudhën e provës etj. Komisioni mund të intervistojë kandidatin për postin e ri.

3. Për personat që nuk janë nëpunës civilë, sipas kuptimit të këtij ligji, emërimet pa konkurs bëhen për një periudhë kohe jo më të gjatë se tre vjet. Kjo bëhet kur këshilli emërues vërteton dhe komisioni bie dakord me faktin që plotësimi i postit vakant është një kërkesë urgjente dhe e një natyre të përkohshme.

Personat e emëruar sipas pikës 3 do të gëzojnë statutin e nëpunësit civil sipas përcaktimeve të këtij ligji vetëm gjatë kohës së shërbimit. Komisioni, në marrëveshjen e lidhur me pranimin e emërimeve pa konkurs, sipas pikës 3, mund të vendosë kushte të veçanta për kohëzgjatjen e shërbimit në këtë detyrë dhe për zgjedhjen e kandidatëve.

Neni 25

Integrimi i nëpunësve ekzistues në shërbimin civil

Nëpunësit ekzistues në shërbimin civil, të cilët punojnë në ato detyra që përfshihen nga ky ligj për një periudhë jo më të vogël se një vit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, fitojnë statusin e nëpunësit civil kur, me kërkesën e tyre, marrin një certifikatë kualifikimi nga ana e komisionit të shërbimit civil.

Kërkesa duhet të shoqërohet me:

1. Një pasqyrë të detyrave e kompetencave të postit në të cilin ka punuar nëpunësi, e vërtetuar nga këshilli emërues.

2. Një paraqitje e kualifikimeve, përvojës së punës dhe cilësive personale të kërkuesit, në mbështetje të kërkesës së tij.

3. Një raport vlerësimi nga këshilli emërues në lidhje me mënyrën e realizimit të detyrave nga ana e kërkuesit.

Komisioni i lëshon kërkuesit certifikatën e kualifikimit kur rezulton se kualifikimi dhe përvoja e punës e kërkuesit plotësojnë kushtet për të punuar si nëpunës civil në shërbimin civil të nivelit përkatës dhe kur këshilli emërues vërteton se personi i ka kryer detyrat e tij në mënyrë plotësisht të kënaqshme.

Kur komisioni i shërbimit civil është i mendimit se nëpunësi nuk zotëron kualifikimin e nevojshëm për nëpunësin civil, atëherë ai njofton nëpunësin dhe këshillin emërues për këtë gjë.

Kur komisioni i shërbimit civil është i mendimit se nëpunësi nuk zotëron kualifikimin e nevojshëm për nëpunësin civil në momentin e bërjes së kërkesës, por mund të kualifikohet brenda një periudhe të arsyeshme, jo më gjatë se dy vjet, duke plotësuar me sukses një ose disa nga kushtet e mëposhtme:

a) fiton kualifikime të veçanta,

b) përfundon me sukses kurse specializimi a trainimi,

c) realizon me sukses një a disa detyra të veçanta që do t'i caktohen, atëherë ai njofton nëpunësin dhe këshillin emërues për këtë gjë dhe bën pezullimin e marrjes së vendimit deri në përfundim të kësaj periudhe.

Kur nëpunësi, brenda 12 muajve pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk bën kërkesë pranë komisionit për të marrë certifikatën e kualifikimit ose kur komisioni nuk i lëshon atij këtë certifikatë, atëherë nëpunësi nuk fiton statusin e nëpunësit civil dhe:

- a) largohet nga detyra ose
- b) kur është e nevojshme për nevojat e organit a të institucionit, konsiderohet si i emëruar pa konkurs, sipas kushteve të pikës 3 të nenit 24.

Nëpunësit eksitues në shërbimin civil, të cilët punojnë në detyra që përfshihen nga ky ligj për një periudhë jo më të gjatë se një vit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, fitojnë statusin e nëpunësit civil kur i nënshtrohen një provimi të organizuar nga komisioni i shërbimit civil në bashkëveprim me këshillin emërues, sipas kërkesave të përcaktuara prej tyre.

Nëse këta nëpunës nuk plotësojnë kërkesat e provimit, atëherë ata nuk fitojnë statusin e nëpunësit civil dhe

- a) largohen nga detyra,
- b) vendosen në një nivel shërbimi më të ulët, në përputhje me rezultatin e provimit, në një detyrë që caktohet nga këshilli emërues. Kur nuk ka vende bosh në nivelin përkatës, atëherë ata vendosen në një listë pritjeje derisa të lirohen vende të tilla.

Neni 26 **Kualifikimi**

Futja në shërbimin civil dhe zhvillimi i karrierës së nëpunësve civilë bëhen në bazë të kualifikimit të nëpunësve.

Këshilli i Ministrave përcakton kushtet dhe kërkesat për kualifikimin e përgjithshëm të nëpunësve civilë që do të punojnë në nivelet e ndryshme të shërbimit civil, si dhe kërkesat për kualifikime speciale për detyra të veçanta.

Neni 27 **Periudha e provës**

Të gjitha emërimet, në bazë të këtij ligji, të nëpunësve civilë bëhen për një periudhë prove që zgjat 12 muaj. Nëpunësit civilë, gjatë gjithë periudhës së provës, konsiderohen civilë në provë.

Në fund të periudhës së provës këshilli emërues duhet:

1. Të konfirmojë emërimin e nëpunësit civil, kur është i mendimit se nëpunësi i ka realizuar detyrat në mënyrë të kënaqshme.

2. T'i japë fund emërimit të nëpunësit civil në provë, kur është i mendimit se nëpunësi nuk i ka realizuar detyrat në mënyrë të kënaqshme dhe e njofton atë për vendimin e tij. Nëpunësi në provë mund t'i drejtohet komisionit të shërbimit civil, në rast se është i mendimit se vendimi i marrë nga këshilli emërues është i padrejtë.

Komisioni i shërbimit civil, në rastet e pikës 2 të paragrafit të mësipërm, i kërkon këshillit emërues informacion të argumentuar për vendimin e tij për t'i dhënë fund emërimit. Pasi shqyrton çështjen, komisioni merr vendimin përkatës. Në rast se komisioni vendos për lënien në fuqi të emërimit, atëherë:

1. Nëpunësi emërohet në një vend tjetër pune, në një detyrë të të njëjtit nivel e në të njëjtat kushte, kur një vend i tillë ekziston dhe kur nëpunësi e pranon atë.

2. Kur një vend i tillë nuk ekziston, nëpunësi emërohet në të njëjtin vend pune ku ishte në provë.

Në çdo kohë, gjatë periudhës së provës, këshilli emërues mund të bëjë vlerësime për realizimin e detyrave nga ana e nëpunësit në provë. Në rast se këshilli emërues është i mendimit se nëpunësi në provë ka dhënë prova të mjaftueshme për aftësitë e tij profesionale ose është i mendimit se ai nuk i realizon detyrat në mënyrë të kënaqshme dhe nuk është i aftë për të kryer detyrën, atëherë ai mund të vendosë përfundimin e periudhës së provës para afatit njëvjeçar. Këshilli emërues mund të zgjasë periudhën e provës edhe pas mbarimit të afatit një-vjeçar, për një periudhë jo më shumë se gjashtë muaj, në qoftë se është i mendimit se nëpunësi nuk ka dhënë prova të mjaftueshme për aftësitë e tij profesionale, duke përcaktuar edhe kërkesat specifike që duhet të plotësojë nëpunësi.

Neni 28

Karriera e nëpunësve civilë

Ngritja në detyrë e nëpunësve civilë, në detyra që i përkasin shkallëve të karrierës të të njëjtit nivel, dhe ngritja në detyrë në nivele më të larta të karrierës formojnë karrierën e nëpunësve civilë.

Zhvillimi i karrierës dhe ngritja në detyrë e nëpunësve civilë bëhet në përgjithësi sipas sistemit të karrierës, dhe në raste të veçanta sipas sistemit të posteve në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Shkallët e karrierës për secilin nivel, nivelet e karrierës, kushtet, kriteret dhe afatet për zhvillimin e karrierës, kërkesat për kualifikimin dhe procedurat përkatëse përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Vendimet për karrierën e nëpunësve civilë merren nga komisioni i shërbimit civil në bashkëveprim me këshillat emërues, mbi bazën e dosjeve të personelit.

Neni 29

Dosja e personelit

Dosja e personelit është përmbledhje dokumentesh individuale për çdo nëpunës, në të cilën futen të dhëna të karakterit teknik e administrativ, si dhe informacione për vlerësimin periodik të punës së çdo nëpunësi civil. Forma, standardet dhe rregullat për mënyrën e mbajtjes dhe administrimit të dosjes së personelit miratohen nga Këshilli i Ministrave.

Me miratimin e Departamentit të Administratës Publike, organet dhe institucionet e veçanta mund t'i shtojnë dosjes së personelit elemente të veçanta, sipas nevojave specifike të tyre.

Dosja e personelit mbahet në drejtorinë e personelit dhe të organizimit të organeve dhe institucioneve përkatëse.

Dosja e personelit mund t'u jepet vetëm:

1. Nëpunësit, të cilët i përket dosja.
2. Nëpunësve të drejtorive të personelit e të organizimit që merren me mbajtjen dhe sistemimin e dosjeve të personelit.
3. Personave të ngarkuar për të bërë vlerësimin e nëpunësit.
4. Komisionit të shërbimit civil, në rastet kur një gjë e tillë është e nevojshme për kryerjen e detyrave të tij.
5. Këshillit emërues, në rastet kur një gjë e tillë është e nevojshme për kryerjen e detyrave të tij.

Informacionet e dosjes së personelit nuk mund t'i jepen asnjë personi tjetër, përveç personave të përmendur më sipër. Personat e përmendur në pikat 2, 3, 4 dhe 5 të këtij paragrafi mbajnë përgjegjësi për ruajtjen e fshtetësisë së informacionit që ndodhet në dosjen e personelit.

Nëpunësi, të cilët i përket dosja, ka të drejtë të mbajë qëndrim me shkrim për çdo informacion ose vlerësim që ndodhet në dosjen e tij. Këto shkresa futen në këtë dosje.

Neni 30

Lirimi i përkohshëm nga detyra dhe qarkullimi

Për nevojat e organeve dhe institucioneve publike, nëpunësit civilë mund të lirohen përkohësisht nga detyra ose të qarkullojnë, në rastet e mëposhtme:

1. Kur numri i nëpunësve civilë në një organ a institucion të caktuar është më i madh se numri i nëpunësve të nevojshëm për realizimin e detyrave dhe ky numër duhet të zvogëlohet, atëherë Këshilli i Ministrave merr vendim për numrin e nëpunësve civilë që do të shkurtohen dhe për sistemimin e tyre në organe a institucione të tjera. Në qoftë se në shërbimin civil nuk ka vende të lira, nëpunësit e shkurtuar mbeten në pritje, por zënë me përparësi vendet ekuivalente që ngelen bosh në shërbimin civil. Për periudhën e lirit të përkohshëm nga detyra, këta nëpunës paguhen në masën që caktohet nga sistemi i pagave në shërbimin civil për këtë kategori nëpunësish.

2. Kur në një organ a institucion lind një nevojë e domosdoshme dhe urgjente për kryerjen e një detyre të caktuar, e cila mund të realizohet nga një ose disa nëpunës civilë të organeve a institucioneve të tjera, atëherë këshilli emërues i organit a institucionit përkatës i kërkon komisionit të

shërbimit civil që t'i vëre në dispozicion nëpunësit e nevojshëm për kryerjen e detyrës. Në kërkesë duhet të përshkruhet rëndësia dhe urgjenca e detyrës, emrat e nëpunësve civilë që mund ta kryejnë atë, ose kërkesat e nevojshme për aftësitë profesionale. Komisioni, në bashkëpunim me organet a institucionet e interesuara, merr masat për plotësimin e kërkesës.

3. Kur nëpunësi civil kërkon vetë të qarkullojë ose kur ai është dakort me propozimin për qarkullimin, atëherë është i mjaftueshëm miratimi i organit a institucionit ku ai punon dhe i organit a institucionit në të cilin ai do të punojë.

Qarkullimi i nëpunësve bëhet në detyra të barasvlershme me detyrat që ata ushtrojnë, me përjashtim të rasteve kur nëpunësit pranojnë të shkojnë në një detyrë më të ulët. Në rast se nëpunësi merr pagën e detyrës së re, atij i njihet shkalla e kualifikimit të tij më të lartë dhe nëpunësi gëzon me përparësi të drejtën për të punuar në një detyrë tjetër që i përgjigjet shkallës së tij të kualifikimit.

Neni 31

Procedurat e largimit nga puna

Kur këshilli emëruës, për një nga arsyt e përmendura në këtë ligj, propozon largimin nga puna të nëpunësit civil, atëherë ky i fundit ka të drejtë të ankohet pranë komisionit të shërbimit civil, i cili i kërkon këshillit emëruës informacion për arsyet për largimin nga puna të nëpunësit. Pasi shqyrton çështjen, komisioni merr vendimin përkatës. Në rast se komisioni vendos për lënien në fuqi të emërimit, atëherë:

1. Nëpunësi emërohet në një vend tjetër pune, në një detyrë të të njëjtit nivel e në të njëjta kushte, kur një vend i tillë ekziston dhe kur nëpunësi e pranon atë.

2. Kur një vend i tillë nuk ekziston, nëpunësi mbetet në të njëjtin vend pune.

Kur propozimi për largimin nga puna bëhet për paaftësi të nëpunësit për të kryer detyrat në shërbimin civil dhe këshilli emëruës nuk e ka vënë në dijeni nëpunësin, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës, për mangësitë e vërejtura në punën e tij e nuk i ka dhënë mundësi që të përmirësojë rezultatet e punës së tij, duke përfshirë edhe asistencën e trajnimit që i takon të marrë, atëherë komisioni mund të vendosë që nëpunësi të vazhdojë punën në detyrën e tij, duke i krijuar të gjitha mundësitë që i takojnë për përmirësimin e rezultateve të punës.

Kur komisioni është i mendimit se nëpunësi, për të cilin propozohet largimi nga puna për paaftësi për të kryer detyrat në shërbimin civil, mund të kryejë detyra të një shkalle më të ulët, atëherë ai mund të vendosë që nëpunësi të punojë në një detyrë më të ulët, në përputhje me aftësitë e tij. Në rast se për këto detyra nuk ka vende bosh, atëherë ai mbetet në pritje sipas kushteve të pikës 1 të nenit 30 dhe gëzon përparësi për t'u emëruar, në raport me kandidatët e zgjedhur me konkurs, për të punuar në shërbimin civil në detyrat në fjalë.

Kur propozimi për largimin nga puna bëhet për paaftësi në kryerjen e detyrave dhe nëpunësi pretendon ose këshilli emëruës është i mendimit se paaftësia për kryerjen e detyrave rrjedh nga një arsye shëndetësore, të cilat e pengojnë nëpunësin për të kryer detyrat në shërbimin civil, atëherë këshilli emëruës duhet t'i kërkojë paraprakisht nëpunësit që të paraqesë një dokument të ekzaminimit mjekësor nga mjeku specialist. Nëse nëpunësi nuk pranon të kryejë ekzaminimin mjekësor, atëherë ai mund të pezullohet nga detyra, derisa të kryejë ekzaminimin mjekësor dhe nuk i jepet pagë për periudhën e pezullimit.

Pas marrjes së raportit të ekzaminimit mjekësor, me të cilin vërtetohet ekzistenca e arsyeve shëndetësore që e pengojnë nëpunësin të kryejë detyrat në shërbimin civil, atëherë këshilli emëruës vendos:

1. të pezullojë nëpunësin deri në përmirësimin e gjendjes shëndetësore, kur problemi shëndetësor është i përkohshëm.

2. të propozojë largimin nga puna të nëpunësit, kur problemi shëndetësor është i përhershëm.

Në këto raste shpërblimi i nëpunësit bëhet në bazë të dispozitave juridike përkatëse.

Këshilli emëruës duhet të njoftojë nëpunësin për përfundimet që ka nxjerrë nga rezultatet e ekzaminimit mjekësor dhe t'i krijojë mundësinë nëpunësit që të kërkojë një ekzaminim të dytë. Ai është i detyruar ta rishqyrtojë çështjen edhe një herë pas ekzaminimit të dytë.

Këshilli i Ministrave mund të caktojë një a më shumë grupe mjekësh specialistë për ekzaminimin e rasteve të mësipërme.

Disiplina e nëpunësve civilë

1. Shkeljet disiplinore.

Shkeljet disiplinore janë:

a) Moskryerja e detyrave pa shkaqe të pranueshme dhe sjellja e keqe gjatë kohës së kryerjes së detyrave.

b) Dëmtimi pa shkaqe të pranueshme i pronës së shtetit ose krijimi i rrezikut për një dëmtim të tillë.

c) Një veprim i kryer pa shkaqe të pranueshme, i cili është në konflikt me rregullat e etikës së shërbimit civil ose që diskrediton një nëpunës civil ose institucion apo shërbim civil, pavarësisht nëse kryhet brenda ose jashtë zyrës.

2. Masat disiplinore.

Llojet e masave disiplinore janë:

a) vërejtja paralajmëruese;

b) gjobë që nuk e kalon rrogën e dhjetë ditëve të punës së nëpunësit civil;

c) pezullim nga puna për jo më shumë se dhjetë ditë dhe mospagim i rrogës për dyfishin e ditëve të pezullimit;

d) ulja e nivelit të pagës deri në tre nivele më poshtë për jo më shumë se një vit;

e) largimi nga puna i nëpunësve civilë dhe heqja e së drejtës për të punuar në shërbimin civil.

Kjo masë shoqërohet me humbjen e statusit të nëpunësit civil dhe të drejtave që burojnë prej tij.

Për një shkelje disiplinore mund të jepet vetëm një masë disiplinore.

3. Dhënësi i masave disiplinore.

Dhënia e masave disiplinore ndaj nëpunësve civilë është përgjegjësi e po atyre autoriteteve që përgjigjen për zgjidhjen dhe emërimin e tyre sipas rregullave të përcaktuara nga ky ligj dhe procedurave të hartuara nga Këshilli i Ministrave në zbatim të tyre.

Kur titullari i institucionit e delegon kompetencën për të vendosur nëse ka ndodhur ose jo një shkelje disiplinore, ai nuk duhet të marrë pjesë në procesin e marrjes së këtij vendimi.

4. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për disiplinën në shërbimin civil, të cilat duhet të përmbajnë detaje për:

a) shkeljet disiplinore;

b) llojet e masave disiplinore;

c) raportin e masave disiplinore me detyra e nëpunësve të përcaktuara nga ky ligj dhe nga Etika e Shërbimit Civil;

d) rregullat procedurale për dhënien e masave disiplinore;

e) garancitë procedurale për t'u mbrojtur nga masat e padrejta disiplinore, përfshirë edhe asistencën juridike;

f) organet që japin masa disiplinore;

g) pasojat juridike e financiare të masave disiplinore;

h) afatet e shlyerjes së masave disiplinore.

Masat disiplinore shënohen në dosjen personale të nëpunësit. Afatet e ruajtjes së evidentimit të masës disiplinore në dosjen e personelit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Të drejta të veçanta

Nëpunësi civil gëzon edhe këto të drejta të veçanta:

1. Të drejtën për të pasur një punë të garantuar në shërbimin civil, deri me daljen në pension, sipas kushteve dhe kërkesave të këtij ligji.

2. Të drejtën për të përparuar në karrierë, në përputhje me dispozitat juridike përkatëse.

3. Të drejtën për të marrë, me shpenzimet e shtetit, trainimin e nevojshëm, të parashikuar për zhvillimin e karrierës së tij dhe të drejtën për të marrë leje studimesh.

4. Të drejtën për të mos qarkulluar pa pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në këtë ligj, kur ky qarkullim është i domosdoshëm për nevojat e funksionimit e të ristrukturimit të shërbimit civil.

5. Të drejtën për të shprehur lirisht pikëpamjet e tij rreth çdo problemi që lidhet me detyrat e tij, në mënyrën dhe sipas procedurave me karakter të përgjithshëm, të përcaktuara në rregulloret përkatëse të funksionimit të organeve a institucioneve.

6. Të drejtën për t'u anëtarësuar në parti a organizata me karakter politik, me përjashtim të rasteve kur: kjo gjë është e ndaluar me ligj, është në kundërshtim me detyrën e tyre ose i pengon ata në ushtrimin e saj. Nuk lejohet punësimi në zyrat e partive ose organizatave me karakter politik.

7. Të drejtën për t'u anëtarësuar në një sindikatë a shoqatë profesionale dhe të drejtën për të formuar sindikata a shoqata profesionale duke përfshirë edhe ato që krijohen për negocimin e kontratave kolektive. Veprimtaria e tyre ushtrohet në përputhje me rregullat e vendosura nga Këshilli i Ministrave në interes të funksionimit të rregullt të shërbimit civil. Ato mund të mbrojnë edhe interesat e individëve të veçantë.

8. Të drejtën për të marrë shpërblime suplementare gjatë kohës së shërbimit, në rastet e mëposhtme:

a) Kur punohet në zona të vështira ose në kushte të vështira.

b) Për udhëtime pune.

c) Për kushte të vështira strehimi.

ç) Për punë jashtë orarit.

d) Për rezultate shumë të mira pune.

Këshilli i Ministrave përcakton kriteret dhe masën e këtyre shpërblimeve.

9. Të drejtën për të marrë shtesa pensionesh sipas ligjeve dhe akteve nënligjore të veçanta.

Neni 34

Mbrojtja e të drejtave

Kur nëpunësit civil i mohohen ose i shkelen të drejtat që i garantohen me këtë ligj, atëherë ai ankohet me shkrim në këshillin emërues, i cili pasi shqyrton problemin, njofton nëpunësin me shkrim për vendimin e tij dhe për masat për vendosjen në vend të të drejtave të nëpunësit, në rast se ai gjykon se nëpunësi i janë shkelur të drejtat.

Nëpunësi civil mund të ankohet në komisionin e shërbimit civil kur:

1. E konsideron të padrejtë vendimin e këshillit emërues.

2. Masat e vendosura nga këshilli emërues për rivendosjen në vend të së drejtës, i quan të pamjaftueshme.

Vendimi i komisionit të shërbimit civil është i detyrueshëm për këshillin emërues. Nëpunësi civil mund të ankohet në Gjykatë ndaj vendimit të komisionit, brenda dhjetë ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim.

Neni 35

E drejta e grevës

Nëpunësit civilë nuk kanë të drejtë të bëjnë grevë.

Neni 36

Pjesëmarrja e nëpunësve të shërbimit civil në procesin e vendim-marrjes

Nëpunësit civilë kanë të drejtë të marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve në rastet kur këto vendime kanë të bëjnë me probleme të personelit, si: kushtet e punës, detyrat dhe të drejtat e nëpunësve civilë, problemet e rekrutimit dhe zhvillimit të karrierës, të pagave etj.

Pjesëmarrja e nëpunësve civilë në këtë proces realizohet nëpërmjet sindikatave, shoqatave profesionale ose nga përfaqësues të zgjedhur të tyre.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 37

Kontrolli i kostos së shërbimit civil

Këshilli i Ministrave kontrollon koston e shërbimit civil dhe bën harmonizimin e saj me numrin e përgjithshëm të nëpunësve civilë, aftësitë paguese të buxhetit të shtetit, garantimin e funksionimit optimal të shërbimit civil, garantimin e të drejtave të nëpunësve civilë në përputhje me mundësitë financiare të buxhetit të shtetit. Këshilli i Ministrave vendos rregulla për procedurat e veçanta që lehtësojnë kontrollin mbi numrin e nëpunësve civilë, koston dhe efektivin e shërbimit civil dhe i raporton Kuvendit Popullor një herë në vit për këto probleme.

Neni 38

Kontrolli dhe rregullimi i shërbimit civil

Në zbatim të dispozitave të këtij ligji, Këshilli i Ministrave formon një grup pune ndërinstitucional për krijimin dhe zbatimin e “sistemit të menaxhimit të shërbimit civil”, i cili përfshin të gjitha masat për kontrollin dhe rregullimin e shërbimit civil, si dhe për hartimin e akteve nënligjore në bazë e për zbatim të këtij ligji.

Neni 39

Trainimi

Sistemi i trainimit të nëpunësve civilë dhe lidhja e tij me zhvillimin e karrierës dhe ngritjes në detyrë, kushtet e trainimit dhe kriteret e futjes në të vendosen nga Këshilli i Ministrave.

Këshilli i Ministrave merr masa që trainimi të planifikohet, të organizohet sistematikisht dhe të mbulojë gjithë shërbimin civil.

Këshilli i Ministrave të marrë masa për mbulimin financiar të koston së trainimit.

Neni 40

Masat për periudhën tranzitore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të marrë masat e nevojshme për përshtatjen e këtij ligji me praktikën e deritanishme në veprimtarinë e administratës publike, të hartojë një program me afatet kohore për zbatimin e dispozitave të veçanta të këtij ligji, ku të përcaktohen edhe afatet kohore për nxjerrjen e akteve nënligjore.

Mosmarrëveshjet që lindin para fillimit të veprimit të këtij ligji midis nëpunësve, mbi të cilët shtrihen efektet e këtij ligji, dhe organeve a institucioneve, në të cilat ata punojnë, do të rregullohen në bazë të legjislacionit ekzistues, me përjashtim të rasteve kur ligji për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë është më i favorshëm për nëpunësin civil.

Neni 41

Çdo dispozitë juridike që vjen në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Neni 42

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1445, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha